



**NË MES NESH
NUK KA KURRË NDARJE!**



**MESAZHI I PRESIDENTIT
TË REPUBLIKËS NË IFTARIN ME
MEDIAT, PAS NATËS SË KADRIT**



**DEBAT RRETH SHKËPUTJES
SË MARRËDHËNIEVE
FAMILJARE**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 24 - Nr. 3 (277), Mars, 2026

www.myftinia-shkoder.org

  MYFTINIA SHKODER1990



“AGJËRIMI I RAMAZANIT,
RRITJE SHPIRTËRORE
DHE SHËNDET I GARANTUAR!”

RINIA GJALLËRON XHAMINË E PARRUCËS
NË NATËN E MADHE TË KADRIT

MYFTINIA SHKODËR SHTRON IFTAR
ME RASTIN E 7 MARSIT,
DITËS SË MËSUESIT

BEREQETI I MUAJIT TË BEGATË
TË RAMAZANIT, QINDRA PAKO USHQIMORE
PËR FAMILJET NË NEVOJË

IFTARI I VËLLAZËRISË
DHE HARMONISË ISLAME NË SHKODËR

DITA E FITËR BAJRAMIT
FESTOHET ME MADHËSHTI
NGA MUSLIMANËT E SHKODRËS



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

NË MES NESH NUK KA KURRË NDARJE!

(Mesazh me rastin e Fitër Bajramit 1447)

Kaluam një muaj të begatë plot mirësi dhe bekim. Kaluam një muaj në paqe totale me njëri-tjetrin, me natyrën, me jetën, me të gjithë përreth.

Duam gjithashtu, që edhe pas largimit të këtij Muaji të Begatë, jeta jonë të vazhdojë në këtë ritëm, përkushtimi ynë të vazhdojë në këtë ritëm dhe angazhimi ynë me fjalën e Zotit dhe leximin, kuptimin dhe praktikimin e saj të vazhdojë me këtë ritëm, për t'u dëshmuar përherë e më shumë madhështia e Islamit në mesin tonë..!

Të dashur dhe të shtrenjtë, vëllezër dhe motra besimtarë,

Para ca kohësh ne mblidheshim për të pritur Muajin e Begatë të Ramazanit; para ca kohësh ne bëheshim gati për të hyrë në atmosferën e begatë të Ramazanit!

Para ca kohësh ne përgatiteshim dhe bënim plane se si ta kalonim Muajin e Begatë të Ramazanit, dhe tashmë ne jemi në momentet e fundit të përcjelljes së këtij Muaji të Begatë, me të cilin u gëzuam sa veç një Zot e di; me të cilin morëm dhe dhamë, ndamë dhe përhapëm mirësi dhe dritë nga mirësia dhe drita e Allahut (xh.sh).

Ja ku jemi në momentet e përcjelljes së Muajit të Kur'anit Famëlartë dhe poashtu, ja ku jemi duke pritur Hënën e re të një muaji të ri, i cili na sjell me vete një festë të madhe, një ditë përkushtimi dhe gëzimi, një ditë të madhe adhurimi, bamirësie, bujarie dhe vëllazërie me njëri-tjetrin, që na afron përherë e më shumë me Zotin e Gjithësisë, ashtu siç muaji Ramazan e bëri një gjë të tillë!

Ja ku jemi duke e përcjellur Ramazanin, që tekta e mendoj më vjen ndërmend takimi i dy dijetarëve të

mëdhenj nga koha e shkuar, kur njëri i thoshte tjetrit se po ndahemi; ia kthente në mesin tonë nuk ka kurrë ndarje, as vdekja nuk na ndan, e përtej mja është përherë vendtakimi ynë!

E kështu është edhe me Ramazanin, Muajin e Madhërueshëm të Kur'anit, i cili së bashku me Fjalën e Allahut (xh.sh) e Librin e Tij do të ndërmjetësojnë për gjithsecilin prej nesh inshallah, nesër në Ditën e Gjykimit.

Ja ku jemi për të dëshmuar përherë e më shumë aftësinë tonë për t'u vetëfrenuar atëherë kur duhet dhe për të vepruar atë që duhet kur dhe si duhet.

Ja ku jemi për t'i dëshmuar njëri-tjetrit, e mbi të gjitha Zotit të Gjithësisë, se ne tashmë, nëpërmjet Muajit të Madhërueshëm të Ramazanit e kemi përfaquar dritën e Zotit dhe me të duam të ecim përpara duke ndryshuar rrugëtimet e gjithsecilit në këtë jetë të shkurtër.

Ja ku jemi për t'i dëshmuar njëri-tjetrit se aftësia e besimtarit është ajo që i dëshmon atij mundësinë për të jetuar me dinjitet dhe krenari, me dritën e Zotit dhe bekimet e Tij për t'u ndarë njëherë e përgjithmonë nga

bota e mjegullnajave, hirtësive dhe errësirave që në fakt e marrin njeriun drejt devijimit dhe shthurjes.

Kaluam një muaj të begatë plot mirësi dhe bekim. Kaluam një muaj në paqe totale me njëri-tjetrin, me natyrën, me jetën, me të gjithë përreth. E duam gjithashtu, që edhe pas largimit të këtij Muaji të Begatë, jeta jonë të vazhdojë në këtë ritëm, e përkushtimi ynë të vazhdojë në këtë ritëm dhe angazhimi ynë me fjalën e Zotit dhe leximin e kuptimin e praktikimin e saj të vazhdojë me këtë ritëm, për t'u dëshmuar përherë e më shumë madhështia e Islamit në mesin tonë, për t'u dëshmuar përherë e më shumë mundësia reale që njerëzit kanë, që nëpërmjet fjalës së Zotit dhe fesë së Tij të jetojnë në dinjitet, në paqe dhe në harmoni me njëri-tjetrin, për t'u dëshmuar gjithsecilin prej nesh si mëkëmbës real i Zotit Një.

Ju përhajroj me rastin e Fitër Bajramit dhe ju dëshiroj çdo të mirë dhe bekim, ju dhe familjeve tuaja, tokës sonë, qytetit tonë, mbarë shqiptarëve kudo që janë, botës mbarë, ymetit islam në veçanti.

Me zemër të mirë Fitër Bajramin!

MESAZHI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS NË IFTARIN ME MEDIAT, PAS NATËS SË KADRIT



Ajo na kujton se, një moment i vetëm përulësie dhe reflektimi, përmbajtje dhe sinqeriteti, peshon më rëndë se sa vite të tëra pa reflektim, dhe ndoshta kjo është një kujtesë e çmuar edhe për misionin tuaj, të nderuar profesionistë të medias.

Sepse, gazetaria në kulmin e saj është një formë e agjërimit të fjalës, është aftësia për të mos thënë gjithçka që dëgjon, por vetëm atë që është e vërtetë dhe e dobishme; të thuash vetëm atë që di dhe ta njoftosh atë, pasi që ta verifikosh.

Mbrëmjen e 17 marsit 2026, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Sh.T.Z. Bajram Begaj, shtroi një iftar të veçantë me gazetarët dhe përfaqësues të mediave në vend, në kuadër të Muajit të Begatë të Ramazanit.

Gjatë fjalës së tij, Presidenti Begaj vlerësoi kontributin e gazetarëve, duke theksuar rëndësinë e profesionalizmit, etikës dhe përgjegjshmërisë në raportimin e ngjarjeve. Ai u shpreh se media mbetet një shtyllë e rëndësishme e shoqërisë, duke kontribuar në transparencë dhe në ndërtimin e besimit publik.

Presidenti Begaj u shpreh duke thënë:

“Jemi mbledhur këtu sot pas Natës së Kadrit, Nata e Shenjtë, që në traditën islame përshkruhet si më e vlefshme se njëmijë muaj së bashku!

Ajo na kujton se, një moment i vetëm përulësie dhe reflektimi, përmbajtje dhe sinqeriteti, peshon më rëndë se sa vite të tëra pa reflektim, dhe ndoshta kjo është

një kujtesë e çmuar edhe për misionin tuaj, të nderuar profesionistë të medias. Sepse, gazetaria në kulmin e saj është një formë e agjërimit të fjalës, është aftësia për të mos thënë gjithçka që dëgjon, por vetëm atë që është e vërtetë dhe e dobishme; të thuash vetëm atë që di dhe ta njoftosh atë, pasi që ta verifikosh.

Ky Muaj i Bekuar po largohet, por le të mos largohen vlerat që ky Muaj mbart, dhe bashkë me të, dhe dëshira jonë për të qenë të vërtetë me veten dhe me të tjerët.

Uroj që forca që gjetën gjatë agjërimit, durimi që treguat në pritje të iftarit dhe paqja e këtyre netëve t'ju shoqërojë gjatë gjithë jetës tuaj, e në çdo rresht që shkruani dhe në çdo fjalë që thoni.

Le të jetë e vërteta ajo që na udhëheq dhe mirësia ajo që na bashkon.

Uroj që drita e këtyre ditëve të mbetet e ndezur në çdo shtëpi dhe redaksi tuaj.

Paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ju dhe familjet tuaja.

Agjërimit të pranuar dhe mbarësi paçi gjithmonë në familjet tuaja!”

“A KA NATË KADRI PËR TË ZHYTURIT NË GJYNAHE?”



Ditën e xhuma, më 13 mars 2026, nëpërmjet minberit të xhamisë së Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua besimtarëve me mesazhe shprese dhe mëshira, me të cilat Allahu i Madhëruar e ka bekuar ymetin e Hz. Pejgamberit (a.s).

Gjatë hytbes së xhumasë, Myftiu Sytari u ndal tek mëshira dhe falja e pakufishme e Allahut të Madhëruar për robërit e Tij, në këtë Muaj të Begatë të Ramazanit, si dhe tek bamirësitë e shumta dhe solidariteti me njerëzit në nevojë.

Myftiu tha, se: “Kemi parë dhe kemi dëshmuar falë Allahut të Madhëruar, bamirësinë e njerëzve të ndryshëm për të bërë mirë, për të ndihmuar nevojtarët, për të qenë me njerëzit skamnorë, për t'i ardhur në ndihmë atyre që ndoshta nuk e kanë mundësinë as për një iftar dhe të gjithë në një mënyrë apo një tjetër janë gëzuar dhe janë shënuar në këtë Muaj të Begatë të Ramazanit!”

Myftiu theksoi se, falja dhe mëshira e Allahut në këtë Muaj, sidomos në 10 ditët e fundit të ti, në të cilat tashmë kemi hyrë dhe Ramazanit po i afrohet fundi, janë të pakufishme dhe përfshin shumë prej robërve të Allahut të Madhëruar: “Mendoni vetëm për pak se sa mëshirë e madhe është derdh për mbarë njerëzimin dhe për besimtarët në veçanti në Natën e Kadrit e në këto 10 net të ngelura të këtij Muaji të Begatë të Ramazanit. E thua në këto ditë të ngelura, sepse po shkojmë në javën e fundit, e xhumanë e ardhshme hytbeja do të jetë hytbe e Bajramit dhe jo hytbe Ramazanit.

Mendoni vetëm për pak hadithin e Pejgamberit (a.s.), i cili thotë: ‘Ai i cili e kalon Natën e Kadrit duke u falë dhe duke u lut, atij do t'i falen të gjitha gjynahet e shkuara!’

Allahu Ekber. Çfarë është kjo mëshirë e madhe? Çfarë është kjo falje e madhe? Është Madhëria e Tij (xh.sh), i Cili do të na tregojë se ne jemi nevojtarë për mëshirën e Zotit tonë dhe se dyert e mëshirës së Allahut nuk i mbyllen asnjëherë njeriut!”



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 – 1996)

Islami ka shtyllat dhe parimet e tij mbi të cilat mbështetet, që i ngjajnë ajeteve të qarta (ajat muhkemat), dhe që janë baza e fesë dhe thelbi i saj!

Këto shtylla dhe parime nuk janë çështje kontradiktore (ndryshim mendimesh), edhe pse ekzistojnë qëndrime të ndryshme, që në fakt janë qëndrime sipërfaqësore e nuk kanë peshë.

Le të sjellim një shembull për ta qartësuar qëllimin. Allahu i Madhëruar thotë: “Ose, nëse i prekni gratë, e nuk gjeni ujë, atëherë merrni tejumum, prej dheut të pastër!” – (Kur’ani, En-Nisa: 43)

Prekja, a ka kuptimin e prekjes në përgjithësi, kështu që çdo prekje e prish abdesin apo është shprehje figurative dhe qëllimi është për një prekje të përcaktuar?

Fukahatë kanë pasur mendime të ndryshme, ku fusha e Fikhut është fushë e gjerë për këndvështrime dhe pikëpamje të llojllojshme.

Dijetarët kanë rënë dakord, se ky ndryshim nuk ka problem në të dhe as nuk ka dëm prej tij, që nuk i bën keq Islamit dhe nuk ia prish vlerën çështjes. Por, kur i Dërguari i Allahut (a.s) thotë: “Katër gjëra kush i ka, ai është munafik (hipokrit) i pastër, dhe kush ka një të prej tyre, ka një pjesë prej pjesëve të

DEBAT RRETH SHKËPUTJES SË MARRËDHËNIEVE FAMILJARE

Kuptimi është i qartë, nëse në Fikh ka mendime të ndryshme, atëherë në moral nuk ka mendime të ndryshme.

Kam vënë re, se grupe të ndryshme njerëzish janë shfaqur në këtë kohë, ku lidhja e tyre me akiden (besimin) është e zymtë, lidhja e tyre me morali është e dobët dhe lidhja e tyre me interesat e ymetit është këputur.

hipokrizisë, derisa t’i lërë: Kur i lihet amanet, nuk e mban amanetin; kur flet, gënjen; kur jep besën, e thyen atë, dhe kur armiqësohet, mëkaton (shkatërron shumë!)” – (Transmeton Buhariu dhe Muslimi)

Kuptimi është i qartë, nëse në Fikh ka mendime të ndryshme, atëherë në moral nuk ka mendime të ndryshme.

Kam vënë re, se grupe të ndryshme njerëzish janë shfaqur në këtë kohë, ku lidhja e tyre me akiden (besimin) është e zymtë, lidhja e tyre me morali është e dobët dhe lidhja e tyre me interesat e ymetit është këputur. Lënë parimet (gjërat themelore) të fesë dhe cilësitë e mira të saj, dhe ndërtojnë pikëpamjet fikhere të caktuara e kapen për to deri në ekstrem. Mbi bazën e tyre këpusin marrëdhëniet me të tjerët, kështu që kush nuk është në mendimin e tyre, ai nuk është mysliman! Siç është çështja e rrobave dhe e xhelabijes, çështja e nikabit dhe hixhabit, çështja e fotografimit, këngëve, çështja e minberit me shkallë të larta dhe minberit me shkallë të ulëta, etj.

Atmosferën e rizgjimit islam e kanë mbuluar me re, për shkak të stërgjatjes së poteres rreth këtyre çështjeve.

Debati në këto (çështje) ka mbizotëruar vizionin për të ardhmen e popujve të kërcënuar islamë dhe qëllimeve kryesore fetare!

Bile, armiqtë e Islamit, brenda dhe jashtë, e kanë qëlluar Islamin për vdekje, për shkak të kësaj situate fatkeqe dhe përçarjes së fabrikuar.

Në këto mjedise gjenden *ekstremistët*, të cilët bëjnë keq më shumë, se sa bëjnë mirë, dhe me rrugëtimin e tyre vendosin pengesa përpara njerëzve të mençur.

Armiqtë e Islamit në këtë kohë posedojnë forca përçarëse dhe shfaqja e tyre në këto situata është për të ardhur keq. Ne po vuajmë prej pengesave të trashëguara dhe bashkëkohore, që nëse merremi me to, armiku na shkatërron. Prandaj, le të jemi të qartë në të mësuarit e djelmohave ekstremistë në disa mendime fikhere, se gjendja botërore e myslimanëve nuk e duron këtë ngurtësim!! Dhe, është prej hajrit (të mirës) të gjykuarit përmes këtij rregulli: *Të bashkëpunojmë rreth asaj që biem dakord, dhe ta justifikojmë njëri-tjetrin në atë që nuk biem dakord!*

Unë i shkruaj këto rreshta, ndërkohë që armiqtë e Islamit kanë nisur shfarosjen në Evropë, e minbere e minbere të shumta kanë heshtur, në kohën që kishin më tepër nevojë se kurrë për përmendjen e Allahut!

Ndërkohë, burra e djelmohat nga ne, janë të zënë me debatin e hidhur, se a lejohet dhënia e sadakatul-fitrit në vlerë monetare apo në kokrra (drithëra)?!

Ky është debati i shkëputjes së marrëdhënieve familjare, në kohën kur trualli i Islamit është i tronditur, prandaj a do të kthehet mendja e munguar?!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:
Lavdrim Hamja



Arben Halluni, teolog

I riu Akhenaton, faraon i Egjiptit të Lashtë, pjesë e dinastisë së 18-të, që në fillim të jetës së tij si sundimtar, u shqua për përqendrimin në meditim, reflektim dhe përkushtim në adhurim. Ai kishte një ndjeshmëri të lartë shpirtërore dhe një prirje të theksuar për të kërkuar të vërtetën përtej traditave të trashëguara. Ndryshe nga paraardhësit e tij, ai nuk u kënaq me adhurimin e zakonshëm dhe me pushtetin që i ishte dhënë, por kërkoi një kuptim më të thellë të hyjnore.

Ai nuk ishte një mendje e zakonshme, por një shpirt kërkues dhe reformues, që synonte pastrimin e besimit nga shtresat e shumta të politeizmit. Për këtë arsye, ai u përball me kundërshtime të forta nga klerikët e tempullit të Amonit dhe nga ata që përfitonin nga sistemi i vjetër fetar.

Reformatori Akhenaton e shpalli hapur besimin në një Zot të vetëm – Atonin – dhe refuzoi adhurimin e hyjnive të shumta. Ai ndryshoi edhe kryeqytetin, duke u larguar nga qendra tradicionale e

ALLAHU NË QYTETËRIMET E LASHTA EGJIPTI

pushtetit fetar dhe themeloi një qytet të ri, si simbol i një epoke të re shpirtërore.

Në lutjet e tij, ai përshkruan Zotin si Krijuesin e jetës, si atë që i jep shpirt çdo krijese, që bën të lindë drita dhe që mban në ekzistencë gjithësinë. Ai flet për një Zot që nuk ka ortak, që është burimi i çdo gjëje dhe që përfshin me dijen dhe mëshirën e Tij çdo krijesë.

Në një nga përshkrimet e tij poetike, ai thotë se kur dielli perëndon dhe bie errësira, toka mbushet me frikë dhe krijesat tërhiqen, ndërsa me lindjen e diellit, jeta ringjallet dhe çdo gjë merr gjallëri. Kjo paraqitje e natyrës shndërrohet në një argument për një Zot të vetëm që rregullon gjithësinë me urtësi.

Ai e përshkruan Zotin si Krijuesin e njeriut, të kafshëve dhe të çdo gjëje të gjallë, si Atë që furnizon çdo krijesë dhe që i jep secilit pjesën e vet. Në këtë mënyrë, ai i afrohet konceptit të teuhidit, duke e parë universin si një sistem të unifikuar nën një Zot të vetëm.

Megjithatë, studiues të ndryshëm kanë vënë në dukje se, megjithëse ka ngjashmëri mes himneve të Akhenatonit dhe disa teksteve të tjera të lashta, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht ndikim i drejtpërdrejtë, por mund të jetë rezultat i kërkimit të përbashkët njerëzor për të vërtetën.

Disa prej tyre kanë krahasuar edhe idetë e tij me besimet që u shfaqën më vonë në traditat e tjera fetare, duke vënë

në dukje se nocioni i një Zoti të vetëm nuk ishte i panjohur në botën e lashtë.

Megjithatë, duhet theksuar se teuhidi i pastër, ashtu siç njihet në Islam, dallon qartë nga këto përpjekje të hershme. Edhe pse arabët para Islamit e njihnin emrin “Allah”, koncepti i tyre për Zotin ishte i përzier me shirk dhe ndërmjetësime, ndërsa Islami e pastroi këtë besim dhe e paraqiti në formën e tij të plotë dhe të qartë.

Disa studiues perëndimorë, si Frojdi, kanë trajtuar lidhjen mes ideve të Akhenatonit dhe besimeve të mëvonshme monoteiste, duke sugjeruar se figura e Musait (a.s), mund të ketë lindur në një ambient të ndikuar nga këto ide. Sipas këtyre mendimeve, përhapja e teuhidit në mesin e bijve të Izraelit mund të ketë ardhur si vazhdim i një klime shpirtërore të krijuar më herët.

Megjithatë, këto mbeten analiza historike dhe nuk ndryshojnë faktin se shpallja hyjnore që u erdhi Pejgamberëve është burimi i vërtetë i teuhidit të pastër.

Në realitet, thirrja e Akhenatonit ishte një përpjekje e veçantë, por e kufizuar dhe e rrethuar nga kundërshtime politike dhe fetare. Ajo nuk arriti të rrënojë thellë në shoqëri dhe u shua shpejt pas vdekjes së tij, ndërsa besimet e vjetra u rikthyen.

Ndërkohë, teuhidi që sollën Pejgamberët mbeti dhe u përhap, sepse ishte i mbështetur në shpallje hyjnore dhe jo vetëm në përpjekje njerëzore.



MYFTIU FALI NAMAZIN E TERAVISË ME XHEMATIN E XHAMISË TEK URA E BUNËS



Mbrëmjen e së hënës, më 2 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zgjodhi xhaminë tek Ura e Bunës për të falur namazin e teravisë natën e 13-të të Ramazanit 1447.

Në ligjëratën e kësaj mbrëmjeje, Myftiu iu drejtua të pranishmëve me një këshillë në shërbim të forcimit të besimit dhe përpjekjes për ta shijuar çdo udhëzim të fesë në jetën e përditshme, si dhe nxitjen për t'u bërë gjithësecili thirrës drejt vlerave të fesë së tij me vepra konkrete para fjalës.

Myftiu solli në vëmendje të të rinjve të pranishëm shembullin e tre të rinjve në kohën e Pejgamberit (a.s) që me dëshirën për të bërë më të mirën përzgjedhën të vepronin diçka që më pas Pejgamberi (a.s) e cilësoi si veprim jashtë rrugës së traditës së tij.

Nga këtu, Myftiu theksoi se të qënurit fetar i mirë nuk do të thotë të ndikohesh nga emocionet e momentit a euforia, por ta jetosh Islamin me maturi dhe me hapa të avashtë, duke e dëshmuar mrekullinë e besimit dhe dritën e tij në harmoni me jetën dhe me shoqërinë.

Myftiu falënderoi imamin e xhamisë, H. Ridvan Luzaku, për përkushtimin e tij në edukimin e brezit të ri, fëmijëve në veçanti, si dhe për krijimin e një atmosfere të ngrohtë dhe shpirtërore, nëpërmjet të cilës xhamia kthehet në pikë referimi për krejt komunitetin.



MYFTINIA SHKODËR SHTRON IFTAR ME RASTIN E 7 MARSIT, DITËS SË MËSUESIT



Ditën e shtunë, më 7 mars 2026, me rastin e 7 Marsit – Ditës së Mësuesit, Myftinia Shkodër shtroi një iftar të veçantë në nder të mësuesve, duke shprehur mirënjohje dhe respekt për kontributin e tyre të çmuar në edukimin dhe formimin e brezave të rinj.

Në këtë sofër të begatë të iftarit morën pjesë mësues dhe drejtues institucionesh arsimore, të cilët u bashkuan në një atmosferë të ngrohtë vëllazërore dhe respekti për figurën e mësuesit.

Organizimi i këtij iftari kishte për synim të theksojë rëndësinë e dijes dhe të rolit që mësuesit kanë në ndërtimin e një shoqërie të edukuar dhe të zhvilluar dhe pozitën e lartë që zë figura e mësuesit në fenë islame.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi, në çelje të iftari, pasi që i uroi mësuesit për festën e tyre, ndër të tjera u shpreh, se: Në lidhje me rastin e festës së Ditës së Mësuesit, këtë iftar e kemi konsideruar një simbolikë me vlerë në shërbim të njohjes dhe respektit për figurën e mësuesit. Duke qenë se pozita e mësuesit në fenë tonë islame



ka një vend tepër të lartë, ku vetë Zoti i Gjithësisë e ka përmendur në Kur'anin Famëlartë, se: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?!", si dhe vetë Pejgamberi (a.s) na ka thënë se është dërguar mësues.

Me këtë rast, përshëndeti edhe mësuesi i nderuar z. Muamer Vuci, i cili falënderoi Myftininë Shkodër për organizimin e këtij iftari, në respekt të figurës së mësuesit, të cilët shërbyen me përkushtim të lartë në çdo skaj të vendit për mësimin dhe edukimin e brezave. Ai tha, se ky iftar shpreh edhe njëherë harmoninë fetare që karakterizon qytetin e Shkodrës, duke u mbledhur këtu së bashku mësues pa dallim feje.

Gjithashtu, një fjalë përshëndetëse mbajti edhe drejtori i Medresesë "H. Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, i cili ndër të tjera theksoi, se: Mësuesit kanë qenë dhe mbeten drita e dijes së shoqërisë tonë. Me punën që keni bërë ju, me përkushtimin dhe dashurinë tuaj për arsimin, ju keni formuar brezat e tërë duke u dhënë atyre njohuritë e nevojshme dhe formim shkencor, por edhe edukatën, moralin dhe vlerat njerëzore.

"TË KUJTOJMË ME RESPEKT TË KALUARIT DHE TË QËNDROJMË BESNIK TË TABANIT!"



Përkujtimi me respekt i të kaluarve prej hoxhallarëve, haxhilerëve, shërbyesve besnikë të xhamisë dhe të gjithë atyre besimtarë, prej të cilëve u dëshmuar besimi, morali islam dhe ruajtja e trashëgimisë së pastër të kësaj feje ndër shekuj.

Myftiu: Ditën e diel, më 18 Ramazan 1447, që përkon me 8 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari prezantoi në faljen e namazit të jacisë dhe të teravisë në xhaminë e fshatit Oblikë, Njësia Administrative Ana e Malit.

Në prag të namazit të teravisë, Myftiu iu drejtua besimtarëve të pranishëm me një këshillë dhe mesazh në thelbin e të cilit ishte përkujtimi me respekt i të kaluarve prej hoxhallarëve, haxhilerëve, shërbyesve besnikë të xhamisë dhe të gjithë atyre besimtarë, prej të cilëve u dëshmuar besimi, morali islam dhe ruajtja e trashëgimisë së pastër të kësaj feje ndër shekuj.

Myftiu theksoi se, përkujtimi i mirë i të kaluarve është një shtysë më tepër

drejt ruajtjes me fanatizëm të tabanit shekullor islam në mesin tonë.

Gjatë këshillës së tij, Myftiu Sytari vuri theksin tek rëndësia që ka përkushtimi i muslimanëve në jetën e përditshme për të pastruar njetin e veprave dhe të adhurimeve, për të dëlirësuar zemrën dhe për ta vendosur atë në sitën e besimit, dhe veçanërisht në sitën e këtij Muaji të Begatë të Ramazanit, ku përkushtimi drejt adhurimit është më i dukshëm dhe i pranishëm gjithandej në realitetet tona.

Myftiu u lut që ky Muaj i Begatë të jetë i pranuar për të gjithë besimtarët dhe ditën e ngelura të pjesës së tretë të tij të vinë si një mirësi drejt së cilës të gjithë vërshojnë për të përfutur më të mirën nga mëshira, bekimet dhe falja e Allahut të Madhëruar.



MYFTIU TAKOI IMAMËT E ZONËS SË POSTRIBËS



Ditën e martë, më 10 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim pune imamët e zonës së Postribës, të nderuarit: H. Ardin Selhani – imam i xhamisë Kullaj, H. Agim Hoxha – imam i xhamisë Boks, H. Indrit Plangaj – imam i xhamisë Fshati i Ri, H. Arditi Ulqinaku – imam i xhamisë Milan, H. Smalj Braçi – imam i xhamisë Domën, H. Samet Mataj – imam i xhamisë Ura e Shtrenjtë, H. Fatmir Bushaj – imam i xhamisë Omaraj, H. Isa Brahimi – imam i xhamisë së kalasë së Drishtit, H. Fatmir Sulaj – imam i xhamisë Mes-Myselim, H. Ilir Dizdari, imam i xhamisë Bardhaj, me të cilët diskutoi rreth aktivitetit dhe gjallërisë së jetës fetare përgjatë Muajit të Begatë të Ramazanit.

Gjatë këtij takimi pune, Myftiu vuri theksin tek rëndësia që ka kontributi dhe roli vendimtar i imamëve për përhapjen e mesazheve udhëzuese që ruajnë tabanin dhe hedhin dritë rreth edukimit të brezit të ri me dashninë e Allahut dhe mësimet e traditave të Pejgamberit tonë (a.s).

Gjatë këtij takimi u zhvillua një bashkëbisedim i dobishëm dhe me vlerë, ku imamët e nderuar dhanë mendimet e tyre dhe përvojat personale në raport me aktivitetin e secilës xhami dhe përpjekjet e imamëve tanë të nderuar për të gjallëruar aktivitetin fetar përgjatë Muajit të Begatë të Ramazanit, si një mundësi e artë që i bashkon njerëzit në sofrat e besimit dhe i paqton realitetet tona me dritën e udhëzimit islam.

Gjatë këtij takimi u dhanë edhe disa udhëzime me vlerë në prag të Fitër Bajramit, si dhe u diskutua për çështje me interes të përbashkët në dobi të komunitetit dhe vazhdimësisë së kontributeve në shërbim të njerëzve pa dallim.

SOFRA E IFTARIT TË VËLLAZËRISË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE

TEPE

Ditën e mërkurë, më 4 mars 2026, në ditën e 14-të të muajit të Begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi veprimtarinë e iftarit me nxënësit e mejtepit të xhamisë Tepe.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 20 nxënësve të mejtepit të moshave të ndryshme, të rinjve, imamit dhe mësuesit H. Mirian Peraj, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, dha disa këshilla të dobishme edukative si dhe bëri dualutjen e çeljes së iftarit.

Teologu Halluni shprehu urimet e tij të përzemërta për këtë muaj më plot



mirësi dhe devotshmëri.

Në fund të iftarit, u bë lutja e sofrës nga imami i xhamisë si dhe më pas u falë namazi i akshamit.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet dhe qendrat islame do të vazhdojë rrugëtimin gjatë këtij muaji të Begatë të Ramazanit.

SHIRQ-MUSHAN

Ditën e xhuma, më 6 mars 2026, në ditën e 16-të të muajit të Begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi veprimtarinë e iftarit të radhës me nxënësit e mejtepit të xhamisë Shirq-Mushan, Njësia Administrative Dajç.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 30 nxënësve të mejtepit të moshave të ndryshme, imamit dhe mësuesit të përkushtuar H. Kujtim Cufaj, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu

Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, dha disa këshilla të dobishme edukative për fëmijët si dhe bëri dualutjen e sofrës së begatë të iftarit, që ishte përgatitur nga vetë nxënësit e kursit fetar.

Teologu Halluni shprehu urimet e tij të përzemërta për këtë muaj më plot mirësi dhe devotshmëri.

Në fund të iftarit, u bë lutja e sofrës si dhe më pas u falë namazi i akshamit.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet dhe qendrat islame do të vazhdojë mëtej gjatë këtij muaji të Begatë të Ramazanit.



MURIQAN, ALIMETAJ DHE VELINAJ

Në ditën e 20-të të muajit të begatë të Ramazanit, ditën e martë, më 10 mars 2026, sektori i arsimit pranë Myftinisë Shkodër organizoi një iftar vëllazëror me nxënësit

e mejtepeve të xhamive Muriqan, Alimetaj dhe Velinaj.

Në këtë sofrë iftari morën pjesë rreth 60 nxënës të mejtepeve, të moshave të ndryshme, së bashku me imamët dhe mësuesit e tyre: H. Ajet Sukaj, H. Lulzim Beqiri dhe H. Nebi Alia.

Të pranishëm ishte edhe drejtuesi i arsimit pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili para çeljes së iftarit mbajti një fjalë të shkurtër me këshilla edukative dhe shpirtërore për nxënësit, duke theksuar rëndësinë e Ramazanit në edukimin e brezit të ri.

Më pas ai bëri edhe lutjen e çeljes së iftarit, duke uruar që ky Muaj i Begatë të sjellë mirësi, devotshmëri dhe begati për të gjithë besimtarët.

Në përfundim të iftarit u bë lutja e sofrës, ndërsa më pas të gjithë së bashku falën namazin e akshamit.

Programi i iftareve të vëllazërisë, me nxënësit e mejtepeve dhe qendrat islame të Myftinisë Shkodër, do të vijojë edhe gjatë dhjetëditëshit të fundit të muajit të Ramazanit, duke forcuar frymën e bashkimit, edukimit dhe dashurisë mes besimtarëve.



“AGJËRIMI I RAMAZANIT, RITJE SHPIRTËRORE DHE SHËNDET I GARANTUAR!”

Agjërimi për Allahun sjell shpërblimin (sevapin), ndërsa agjërimi me Allahun detyron afrimin (kurbetin). Agjërimi për Allahun është realizim i adhurimit, ndërsa agjërimi me Allahun është përmirësim i vullnetit.

Agjërimi për Allahun është cilësi e çdo adhuruesi, ndërsa agjërimi me Allahun është cilësi e çdo synuesi (që kërkon të vërtetën).

Ditën e xhuma, më 6 mars 2026, nëpërmjet dërsit të përjavshëm, nga xhamia e Parrucës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari dha disa mesazhe me rëndësi për vlerën dhe madhësinë e muajit të Ramazanit në jetën e njerëzve.

Myftiu hodhi dritë rreth tefsirit të ajetit kur'anor: “Dhe, të agjëroni është më e mirë për ju, nëse e dini!”, ku iu referua interpretimeve të ndryshme që pasurojnë kuptimet e mrekullueshme të këtij ajeti, nëpërmjet të cilit nxitemi të mos humbi asnjë moment nga ky muaj i begatë i Ramazanit, qoftë me agjërimin e ditës, me shfrytëzimin e orëve të tij për adhurime, lutje dhe bamirësi, si dhe përfitimin nga orët e bekuara të netëve të këtij muaji plot begati.

Ndër të tjera, Myftiu iu referua edhe tefsirit të Molla Ali Hereviut (v. 1014 h.), i cili teksta komenton këtë ajat kur'anor, sjell në vëmendje të lexuesit fjalën e madhe të Imam Kushejriut (376 – 465 h.), i cili specifikon sa vijon: “Kushdo që dëshmon muajin (e Ramazanit), agjëron për Allahun; e kushdo që dëshmon Krijuesin e muajit, agjëron me Allahun.

Agjërimi për Allahun sjell shpërblimin (sevapin), ndërsa agjërimi me Allahun detyron afrimin (kurbetin). Agjërimi për Allahun është realizim i adhurimit, ndërsa agjërimi me Allahun është përmirësim i vullnetit.

Agjërimi për Allahun është cilësi e çdo adhuruesi, ndërsa agjërimi me Allahun është cilësi e çdo synuesi (që kërkon të vërtetën).

Agjërimi për Allahun është qëndrueshmëri e gjymtyrëve të jashtme sipas shprehjeve të Sheriatit (ligjit), ndërsa agjërimi me Allahun është qëndrueshmëri e brendshme (e ndërgjegjes) sipas shenjave të Hakikatit (të vërtetës absolute).

Ai që dëshmon Muajin, përmbahet (nga ushqimi e pija) në ditë të caktuara nga gjërat që e prishin agjërimin. Ndërsa ai që dëshmon të Vërtetën (Allahun), përmbahet në çdo kohë nga dëshmitë (vëmendja) ndaj krijesave...”.

Myftiu theksoi se, përtej fjalëve të çuditshme që dëgjojmë herë pas here nga njerëz jashtë botës së besimit, kulturës dhe vlerave intelektuale e qytetëruese, e vërteta e madhe është se nga lindja në perëndim, sot ka një interesim shumë të madh të njerëzve pa dallim feje për të provuar agjërimin e Ramazanit, që përveçse një mënyrë për t'u lartësuar shpirtërisht drejt Zotit të gjithësisë, për të pastruar nefsin nga lëngat e shumta, është njëkohësisht edhe një kurë e jashtëzakonshme që përmirëson funksionim e organizmit dhe rrit cilësinë e shëndetit të njeriut, siç e pohojnë edhe mjekët e shumtë anembanë botës.

E xhumaja e datës 6 mars 2026, shënon edhe ditën e 16-të të këtij Muaji, që do të thotë se gjysma e këtij Ramazani kaloi, prandaj le të shfrytëzojmë kohën dhe mundësitë për të përfituar edhe nga pjesa e ngelur e këtij Muaji plot përfitime.



MYFTIU: “RESPEKTONI MË TË MËDHENJTË DHE MËSHIRONI MË TË VEGJLIT!”



Ditën e enjte, më 12 mars 2026, që përkon me natën e 23-të të Ramazanit 1447, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ishte i pranishëm në xhaminë e fshatit Mes-Myselim, ku drejtoi edhe 20 rekartet e namazit të teravisë.

Në mesazhin e tij përpara të pranishmëve, Myftiu iu drejtua të rinjve me një këshillë të posaçme për të dashur dhe për të respektuar më të mëdhenjtë, si dhe për të përfituar përherë nga prania e gjyshërve në mesin tonë, si një pikë referimi për brezin e ri dhe si një mbështetje e fortë në ruajtjen e tabanit shumëshkullor të besimit islam në mesin tonë.

Myftiu dha disa shembuj konkret nga e kaluara e tij, si dhe udhëzoi të pranishmit për të dëshmuar vlerat e thjeshtësisë islame në përditshmërinë e secili dhe në komunikim me njerëz-tjetrin.

Ndër të tjera, Myftiu tha: “Jam shumë i gëzuar, që sonte jam në mesin tuaj dhe në mesin e zotërinjve tanë, dhe në krye të tyre, H. Nuhin, Allahu e shpërbleftë dhe e begatoftë shëndetin, mundin dhe sakrificën e tij. Unë ju them, sidomos ju djemve të rinj, që duhet me kenë krenarë që jeni bashkëkohës të zotërinjve me thinja të bardha.

Një brez, i cili rritet në praninë e gjyshërve besimtarë, është brez i bekuar nga Zoti i gjithësisë. E, një brez që lidhet me gjyshin, me besimin e gjyshit dhe me rrugën e gjyshit, do të ketë përherë mbarësinë e Allahut të Madhëruar. Një brez, që e ka privuar Zoti nga prania e më të mëdhenjve në jetë, është gjithmonë i çalët në jetën e tij, sepse kur ke gjyshin, ke një pikë referimi. Edhe 100 vjeç të bëhet gjyshi, dhe kur të largohet nga kjo botë, ti ke përherë kujtimet më të mira. Do të thuash, kam shkuar në xhami me gjyshin, më ka bërë dashnia e gjyshit për Allahun e Madhëruar, me dashtë Allahun më tepër. Dashnia e gjyshit për Pejgamberin (a.s), më ka bërë me e dashtë Pejgamberin (a.s)!”



DITA E FITËR BAJRAMIT

FESTOHET ME MADHËSHTI NGA MUSLIMANËT E SHKODRËS

Në një atmosferë shpirtërore dhe me një pjesëmarrje të jashtëzakonshme, në sheshin vakëf të Fushë Çelsë, pranë xhamisë "Ebu Bekër", ditën e xhuma, më 20 mars 2026, u zhvillua ceremonia e faljes së Fitër Bajramit, duke shënuar një nga tubimet më të mëdha të besimtarëve ndër vite. Sheshi dhe ambientet përreth u mbushën plot e përplot, duke reflektuar gjallërinë e besimit dhe dashurinë për këtë festë të madhe islame.

Programi nisi që në orët e para të mëngjesit me faljen e namazit të sabahut nën drejtimin e H. Gëzim Dungaj, ndërsa më pas vijoi me një sërë ligjëratash të përgatitura nga imamët e angazhuar, të cilët përcollën mesazhe me vlerë për jetën shpirtërore dhe shoqërore të besimtarëve.

Në kuadër të këtij programi, imamët: H. Ervil Kuçi, H. Adil Cukali, H. Ardit Hoxha, H. Ruzhdi Plangaj dhe H. Adem Pizga trajtuan tema me rëndësi si: vazhdimësia e adhurimit pas

Ramazanit, vëllazëria islame si çelës i suksesit, kujdesi për rininë dhe e ardhmja, bamirësia si pasuri, fuqia e lutjes, si dhe angazhimi me Kur'anin edhe pas muajit të bekuar.

Mesazhi kryesor në emër të Myftinisë Shkodër u përcoll nga teologu Arben Halluni, i cili në fjalën e tij u ndal tek vlera e familjes në shoqërinë tonë, duke theksuar se një familje e shëndoshë dhe e natyrshme është themeli i një shoqërie të fortë dhe të qëndrueshme. Ai bëri thirrje për ruajtjen e harmonisë, respektit dhe dashurisë brenda familjes, si dhe për forcimin e lidhjeve mes njëri-tjetrit.

Namazi i Fitër Bajramit u drejtua nga H. Idmir Plaku, duke u shoqëruar me hytben e rastit, ku përcollti mesazhe paqeje, faljeje dhe solidariteti.

Kjo ditë e bekuar u përmbyll me urime të ndërsjella dhe emocione të veçanta, duke dëshmuar edhe një herë se Bajrami mbetet simbol i unitetit, dashurisë dhe lumturisë mes njerëzve.



BEREQETI I MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT

105 PAKO USHQIMORE PËR SHOQATËN E TETRAPLEGJIKËVE

Ditën e martë, më 10 mars 2026, në kuadër të aktiviteteve bamirëse dhe humanitare të Muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër shpërndau sot 105 pako ushqimore për anëtarët e Shoqatës së Tetraplegjikëve në Shkodër. Ky aktivitet kishte për qëllim mbështetjen e familjeve në nevojë dhe të përcjellë frymën e solidaritetit dhe kujdesit për njëritjetrin që karakterizon këtë Muaj të bamirësisë.

Pakot ushqimore u shpërndan sot anëtarëve të Shoqatës së Tetraplegjikëve në Shkodër, me kryetar, z. Saimir Ustabeqiri, i cili me këtë rast shprehu



mirënjohjen për këtë ndihmë dhe për vëmendjen e vazhdueshme që Myftinia Shkodër tregon ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre.

Në emër të Myftinisë Shkodër, përshëndeti teologu Ervil Kuçi, i cili theksoi rëndësinë e solidaritetit dhe ndihmës ndaj atyre që kanë më shumë nevojë, sidomos gjatë Muajit të Begatë të Ramazanit, duke e cilësuar këtë si një nga vlerat më të bukura të besimit dhe fesë islame.

Ky projekt ndihmesh është rezultat i bashkëpunimit tashmë disa vjeçar ndërmjet Myftinisë Shkodër dhe fondacionit bamirës Helping Hand USA.

Falë këtij bashkëpunimi, për këtë vit janë siguruar gjithsej 170 pako ushqimore, të cilat janë planifikuar të shpërndahen për familjet dhe shtresat në nevojë.

Myftinia Shkodër falënderon Helping Hand USA për mbështetjen e tyre disa vjeçare me projektet të ndryshme bamirëse, të cilat kanë një ndikim dhe vlerë shumë të madhe për shtresat e ndryshëm në vendin tonë.

Si përherë, Myftinia Shkodër vijon edhe gjatë këtij Ramazani të jetë pranë familjeve dhe shtresave në nevojë, duke organizuar aktivitete dhe nisma humanitare që synojnë të lehtësojnë sadopak vështirësitë e familjeve në nevojë dhe të forcojnë frymën e solidaritetit mes njëritjetrit.



30 PAKO NË FSHATIN OMARAJ TË POSTRIBËS

Ditën e hënë, më 16 mars 2026, në kuadër të aktiviteteve humanitare gjatë Muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër ka vijuar shpërndarjen e ndihmave ushqimore për familjet në nevojë.

Gjatë ditës së sotme janë shpërndarë 30 pako ushqimore në fshatin Omaraj të Postribës, të cilat iu dedikuan banorëve të këtij fshati. Me këtë rast, përfaqësuesi



i Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi, përcolli edhe mesazhin e solidaritetit dhe kujdesit të Myftinisë Shkodër për familjet në nevojë gjatë këtij Muaji të Begatë.

Këto pako ushqimore janë siguruar nga fondacioni bamirës Helping Hand USA, në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm me Myftininë Shkodër, bashkëpunim që prej disa vitesh ka sjellë mbështetje të rëndësishme për familjet



në nevojë në zonën e Shkodrës. Gjithashtu, me këtë rast, edhe në kalanë e Drishtit u shpërndanë disa pako të tjera, për familjet në nevojë. Përmes këtyre nismave humanitare, Myftinia Shkodër synon të jetë pranë komunitetit dhe të nxisë e forcojë frymën e solidaritetit, veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit, duke ndihmuar familjet dhe njerëzit që kanë më shumë nevojë.

BEREQETI I MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT



40 PAKO NË "NDIHMË TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR MENDORE"

Ditën e martë, më 17 mars 2026, në kuadër të veprimtarive humanitare për Muajin e Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër ka vijuar mbështetjen ndaj shtresave në nevojë, duke shpërndarë 40 pako ushqimore për shoqatën "Në ndihmë të personave me aftësi të kufizuara mendore", dega Shkodër.

Kjo nismë u realizua falë bashkëpunimit me Fondacionin "Mirësia", i cili kontribuoi në sigurimin e pakove ushqimore, duke sjellë një lehtësim për këtë shtresë dhe familjet e tyre.



Në këtë aktivitet bamirës ishte i pranishëm përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Ervil Kuçi, i cili theksoi rëndësinë e solidaritetit, përkujdesjes dhe mbështetjes së vazhdueshme ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe kategorive më të ndjeshme të shoqërisë.

Përmes këtyre iniciativave gjatë Muajit të Begatë të Ramazani, por jo vetëm, Myftinia Shkodër dhe shoqatat e fondacionet me të cilat bashkëpunon, synon të forcojnë frymën e humanizmit dhe të solidaritetit, duke qenë pranë çdo familjeje në nevojë, veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit.

NISIN 10 NETËT E TRETA TË RAMAZANIT 1447



Me këndimin e ezanit të akshamit të ditës së martë, më 10 mars 2026, besimtarët muslimanë të qytetit të Shkodrës hynë në atmosferën e begatë të 10 netëve të treta të muajit Ramazan 1447/2026.

Me këtë rast, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari drejtoi faljen e namazit të jacisë dhe të teravisë në xhaminë e Parrucës, me ç'rast mbajti edhe një ligjëratë nëpërmjet të cilës hodhi dritë rreth vlerave dhe madhështisë së Natës së Kadrit.

Myftiu theksoi se, kjo periudhë e begatë e 10 netëve dhe ditëve të fundit të Muajit të Begatë të Ramazanit i përngjan një personi në duart e të cilit janë vendosur 10 çelësa, ku vetëm njëri prej tyre mund të hapë një sunduk të mbushur me xhevahire.

Ndër të tjera, Myftiu theksoi se gjithësecili prej nesh e ka mundësinë që ta shfrytëzojë kohën e kësaj periudhe të begatë maksimalisht për të mbërritur shpirtin e begatë të Natës së Kadrit, që në vetvete nuk është një trup që preket me dorë, porse një shpirt që përvetësohet për të jetuar përgjatë gjithë jetës.

Myftiu Sytari uroi besimtarët për ditët e kaluara dhe përkushtimin e tyre, si dhe kërkoi nga të pranishmit që në këtë periudhë të begatë kohore të zhvishen nga çdo interes dhe çështje, e afër a e largët, e jetës së përditshme dhe të përkushtohen maksimalisht vetëm në fitimin e pëlqimit të Allahut të Madhëruar, nëpërmjet namazeve ditore, leximit të Kur'anit, lutjeve dhe adhurimeve të shumta.

Gjithashtu, Myftiu vuri theksin që besimtarët të përkushtohen në mënyrë të veçantë për të gjurmuar nevojtarët, skamnorët, njerëzit në nevojë, të sëmurët, e të ngjashëm, të cilët kanë nevojë për dorën e ndihmës, pas së cilës është pëlqimi i Allahut dhe shpirti real i madhështisë së Natës së Kadrit.

Myftinia Shkodër kërkon nga të gjithë besimtarët që ta shfrytëzojnë këtë periudhë të begatë kohore me lutje, adhurime, bamirëse të ndryshme dhe të vrapojnë për të përfutuar maksimalisht nga bekimet dhe mëshira e Allahut që përhapet gjithandej në univers, sidomos në këtë periudhë të begatë të muajit Ramazan.



NGA XHAMIA E PLUMBIT, MYFTIU NXIT SHFRYTËZIMIN E DITËVE TË MBETURA TË RAMAZANIT 1447

Ditën e mërkurë, më 11 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari drejtoi faljen e namazit të teravisë në xhaminë e Plumbit.

Në prag të 20 rekateve të kësaj nate, Myftiu iu drejtua të pranishmëve me një mesazh nëpërmjet të cilit bëri thirrje që ditët dhe netët e ngelura të muajit Ramazan të kenë një përkushtim më të veçantë nga të gjithë besimtarët pa përjashtim.

Myftiu theksoi se, ditët e kaluara të këtij Muaji ishin të mbushura me gjallëri të xhamive tona, me aktivitete, tubime, ligjërata, mesazhe, bamirësi, sofrat iftaresh, tubime të ndryshme dhe u karakterizuan nga një frymë e harmonisë dhe e vëllazërisë në mesin e besimtarëve.

Myftiu kërkoi që ditën e ngelura të këtij Muaji të Begatë të shfrytëzohen maksimalisht edhe si një dëshmi e përkushtimit të madh nga të gjithë besimtarët, të cilët në këto 10 ditë të mbetura kërkojnë me lutjet dhe



Ditën e ngelura të këtij Muaji të Begatë të shfrytëzohen maksimalisht edhe si një dëshmi e përkushtimit të madh nga të gjithë besimtarët, të cilët në këto 10 ditë të mbetura kërkojnë me lutjet dhe përkushtimin e tyre Natën e Kadrit, e cila është më e mirë se sa njëmijë muaj, siç e dëshmon edhe Kur'anin Famëlartë.

përkushtimin e tyre Natën e Kadrit, e cila është më e mirë se sa njëmijë muaj, siç e dëshmon edhe Kur'anin Famëlartë.

Myftiu iu drejtua të pranishmëve me një mesazh, në thelbin e të cilit ishte nxitja për të bërë gjithësecili llogarinë e tij me veten e me Zotin për të përmirësuar

gabimet dhe për të kërkuar falje për gjynahet, si dhe për të përhapur mirësi dhe solidaritet në njerëzit në nevojë, me skamnorët, me njerëzit e braktisur dhe për të përhapur gjithandej dritën e besimit dhe të udhëzimit islam me plot përkushtim dhe krenari.

MYFTIU BËN THIRRJE QË SHPIRTI I RAMAZANIT TË SHËRBEJË PËR RRIJTJEN E MUSLIMANËVE NË SHOQËRI!

Ditën e xhuma, më 13 mars 2026, që përkon më 23 Ramazan 1447, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti dërsin e xhumasë në xhaminë e Parrucës, ku iu drejtua të pranishmëve me disa mesazhe kryesisht për rininë, nëpërmjet të cilave bëri thirrje që shpirti dhe mesazhet e Muajit të Begatë të Ramazanit të ruhen dhe të na shërbejnë për t'u rritur përherë e më shumë në shoqërinë tonë, për t'u ndjerë dhe për t'u dëshmuar madhështia e Islamit në çdo sferë të jetës dhe për t'u prekur gjurma e muslimanëve në çdo sferë të jetës, si një domosdoshmëri për ruajtjen e amanetit të madh të jetës dhe përhapjes së thirrjes islame me çdo frymë.

Ndër të tjera Myftiu theksoi: "Ky është muaji i pendimit, ky është muaji i shpresës, ky është muaji i rimëkëmbjes; ky është një muaj, që sikurse thonë edhe hoxhallarët tanë, ndër ta Dr. Ratib En-Nabulsi, se ai që nuk e ndryshon sjelljen e tij, edhe komunikimin e tij, pas Ramazanit, pra është i njëjti person si ai që hyrë në ditën e parë të Ramazanit,



unë them që agjërimi i tij ka qenë krejt formal!"

Myftiu i bëri thirrje rinisë që me shpirtin e agjëritimit të Ramazanit që e distancon njeriun nga ndalesat dhe nga veprat e shëmtuara, të ecin përpara duke u ndarë nga fenomenet negative të përhapura në masë në shoqërinë shqiptare sot, si: Korrupsioni, mashtrimi, gënjeshtria, tradhtia kombëtare, grabitja e pronës së tjetrit (ku në mënyrë të veçantë u ndal tek grabitja flagrante dhe masakra barbare ndaj vakëfit të

muslimanëve në Fushë Çelë, ku Myftiu tha se përtej përpjekjeve serioze të Kryesisë së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë e të Myftinisë Shkodër, por jo vetëm, realitetet janë këto që dëshmojnë sot!?, imoraliteti, shkatërrimi i familjes, etj.

Dërsi i xhumasë së sotme shënon edhe të xhumanë e fundit të këtij Muaji të Begatë të Ramazanit 1447.

Me mbarësinë e Allahut të Madhëruar, të xhumanë e ardhshme, muslimanët festojnë ditën e parë të Fitër Bajramit.


SOFRA E IFTARIT QË BASHK ON ZEMRAT



Në një atmosferë të ngrohtë solidariteti, mbrëmjen e së shtunës, më 15 mars 2026, u shtrua një sofër iftari e cila mbledhi së bashku besimtarë në frymën e Muajit të Begatë të Ramazanit.

Në koordinim me Myftininë Shkodër, ky iftar u shtrua me bujari nga këngëtari i mirënjohur shkodran z. Bujar Qamili, në një gjest fisnik që pasqyron vlerat e solidaritetit dhe bamirësisë që karakterizojnë këtë Muaj të Shenjtë.

Në këtë iftar mori pjesë edhe teologu Arben Halluni, i cili në përshëndetjen e tij në emër të Myftinisë Shkodër



duke vlerësuar rëndësinë që ka muaji i Ramazanit në forcimin e lidhjeve mes njerëzve dhe në kultivimin e ndjenjës së ndihmës dhe kujdesit për njëri-tjetrin, shprehu gjithashtu falënderimin dhe mirënjohjen për bujarinë e treguar nga këngëtari Bujar Qamili për organizimin e këtij iftari, duke e cilësuar këtë si një vepër të mirë dhe një shembull të bukur solidariteti në muajin e Ramazanit.

Iftari kaloi në një atmosferë shumë të ngrohtë dhe miqësore, ndërsa të besimtarët ndanë së bashku momentin e iftarit, duke u lutur që Zoti Fuqiplotë t'ua pranojë agjërimin dhe veprat e mira të këtij Muaji të Begatë.

PËRSE E KËRKOJMË NATËN E KADRIT?



Ditën e xhuma, më 13 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zgjodhi xhaminë e fshatit Trush për të falur namazin e jacisë dhe të teravisë me besimtarët e shumtë të pranishëm në këtë xhami.

Në prag të namazit të teravisë, Myftiu iu drejtua besimtarëve me një këshillë fetare, nëpërmjet të cilës hodhi dritë rreth vlerave dhe madhështisë së Natës së Kadrit, sikurse ftoi besimtarët që të shfrytëzojnë maksimalisht kohën e ngelur nga 10 ditët e fundit të muajit Ramazan 1447.

Në fjalën e tij, Myftiu iu referua ajeteve të sures El-Kadr, ku Zoti i gjithësisë na tregon për madhështinë e Natës së Kadrit, e cila është "Më e mirë se sa njëmijë muaj!".

Në këtë kontekst, Myftiu vuri theksin

tek mëshira e madhe dhe e pakufishme, me të cilën Zoti i gjithësisë i drejtohet besimtarëve për t'i ftuar drejt dashnisë së Tij, për t'i pastruar nga gabimet dhe gjynahet, për t'i pranuar veprat dhe adhurimet e tyre dhe për t'i lartësuar në gradat më të larta të njerëzve të përkushtuar.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu falënderoi njëkohësisht imamin e xhamisë, H. Jetmir Braçi dhe ndihmësin e tij, H. Elsamed Tula, i cili shërben njëkohësisht edhe në xhaminë e fshatit Golem, për përkushtimin e tyre, për mirëmbajtjen e xhamisë së Trushit, e cila mbetet një shembull i mirë i organizimit të jetës fetare, i pranisë së djemve të rinj dhe besimtarëve të shumtë, që e frekuentojnë xhaminë në aktivitete të ndryshme dhe veçanërisht gjatë Muajit të Begatë të Ramazanit.



IFTARI I VËLLAZËRISË DHE HARMONISË ISLAME NË SHKODËR



Në një atmosferë të ngrohtë vëllazërie dhe bashkimi, Myftinia Shkodër, ditën e shtunë, më 14 mars 2026 organizoi iftarin tradicional të tre Myftinive të trojeve shqiptare: Shkodër, Prizren dhe Ulqin, një veprimtari që forcon lidhjet shpirtërore dhe bashkëpunimin ndërmjet besimtarëve dhe institucioneve islame.

Në këtë iftar morën pjesë Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Valon ef. Ibrahim, kryeimami i Ulqinit, Ali ef. Bardhi, anëtarë të stafit, këshillit të Myftinisë Shkodër, imamë, bashkëpunëtorë, miq e shumë të ftuar.

Në fjalën e tij të përshëndetjes, Myftiu Sytari theksoi se Ramazani është një shkollë e madhe shpirtërore që i afron zemrat, forcon solidaritetin dhe rikujton përgjegjësinë që besimtarët kanë ndaj

njeri-tjetrit dhe ndaj shoqërisë.

Ndërsa kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, Valon ef. Ibrahim, vlerësoi rëndësinë e ruajtjes së unitetit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve islame të trojeve shqiptare, duke e cilësuar këtë iftar si një simbol të bukur të vëllazërisë dhe traditës sonë të përbashkët.

Gjithashtu, kryeimami i Ulqinit, Ali ef. Bardhi, në përshëndetjen e tij theksoi se takime të tilla në muajin e Ramazanit forcojnë lidhjet shpirtërore dhe kultivojnë frymën e dashurisë, respektit dhe harmonisë ndërmjet besimtarëve.

Ky iftar u zhvillua në një atmosferë shumë miqësore dhe vëllazërore, i cili u shoqërua me dua-lutje për njeri-tjetrin dhe u mbyll me faljen me xhemat të namazit të akshamit.

MYFTIU DHE IMAMËT E QYTETIT DISKUTUAN ORGANIZIMIN E FITËR BAJRAMIT

Ditën e shtunë, më 14 mars 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me imamët e ftuar të xhamive: "Ebu Bekër", Kiras, "Dy Vajzave", Medrese, Perash, Kiras, Dërgut e Shirokë.

Gjatë këtij takimi u diskutua rreth organizimit të ceremonisë së Fitër Bajramit, me ç'rast u ra dakord që ceremonia e kësaj dite festive të zhvillohet në sheshin e Vakëfit të Fushë

Çelës, ditën e xhuma, më 20 mars 2026.

U paraqit edhe programi i ceremonisë së Fitër Bajramit dhe u dhanë udhëzimet e duhura për mbarësinë e këtij eventi.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër bën me dije se të gjitha xhamitë e qytetit do të jenë të mbyllura për namaz të sabahut dhe për Fitër Bajram, të cilat do të zhvillohen të organizuara me xhemat në shesh, sipas programit që do të lajmërohet në vijim të ditëve të ngelura të Muajit Ramazan.



CEREMONI ME DUA DHE HATME SHERIFE NË XHAMINË E PARRUCËS



Në kuadër të aktiviteteve të Muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër organizoi ceremoninë e Duasë dhe Hatmes Sherife, e cila u zhvillua ditën e hënë, më 16 mars 2026, pas namazit të ikindisë, në xhaminë e Parrucës.

Në fillim të këtij tubimi shpirtëror, teologu Arben Halluni mbajti një fjalë përshëndetëse dhe një mesazh të veçantë mbi madhësitinë e Natës së Kadrit, duke theksuar rëndësinë që ka lidhja e besimtarit me Librin e Shenjtë, veçanërisht gjatë muajit të Ramazanit.



"Pa dyshim, ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë!"

– (Kur'ani, Fatir: 29)

Në fjalën e tij, ai falënderoi imamët dhe hoxhallarët, të cilët gjatë gjithë muajit të Ramazanit kanë drejtuar me përkushtim mukabelen e përditshme, duke bërë leximin e plotë të Kur'anit Famëllartë dhe duke i dhënë gjallëri xhamive me zërin e fjalës hyjnore.

Ai theksoi se kjo traditë e bukur është një dëshmi e dashurisë së besimtarëve për Kur'anin Famëllartë dhe një mënyrë për ta përjetuar Ramazanin në aspektin e tij më të thellë shpirtëror.

Në përfundim të këtij programi u bë dua-lutja e Hatmes Sherife, ku besimtarët e pranishëm iu drejtuan Allahut (xh.sh) me lutje për mëshirë, falje, paqe dhe begati për familjet e tyre, për qytetin e Shkodrës dhe për mbarë ymetin dhe njerëzimin.

RINIA GJALLËRON XHAMINË E PARRUCËS NË NATËN E MADHE TË KADRIT



Në një atmosferë të ngrohtë shpirtërore, mbrëmjen e të hënës më 27 Ramazan 1447/16 mars 2026, në xhaminë e Parrucës u fal namazi i teravisë me një pjesëmarrje të madhe besimtarësh të moshave të ndryshme, veçanërisht të rinj, të cilët mbushën xhaminë për të përjetuar mirësitë dhe faljet e netëve të fundit të Ramazanit.

Në prag të faljes të namazit të jacisë, teologu Arben Halluni në emër të Myftinisë Shkodër mbajti një fjalë përshëndetëse, ku përcolli disa mesazhe të rëndësishme rreth Natës së Madherueshme të Kadrit, duke theksuar vlerën e jashtëzakonshme që ka kjo natë

në jetën e besimtarit dhe rëndësinë e shfrytëzimit të saj me dua-lutje, adhurim dhe pendim të sinqertë.

Më pas, besimtarët së bashku, nën drejtimin e teologëve H. Arben Halluni dhe H. Gëzim Dungaj falën namazin e jacisë, teravisë dhe vitrit, ndërsa xhamia ishte e mbushur plot me besimtarë, ku spikaste veçanërisht prania e të rinjve.

Kjo pjesëmarrje e gjerë dëshmon gjallërinë e besimit dhe lidhjen e fortë të rinisë me xhaminë dhe vlerat shpirtërore.

Edhe në xhamitë e tjera të qytetit dhe fshatrave ishin të mbushur me besimtarë në kërkim dhe përjetim të Natës së Madhe të Kadrit.



IFTARI I VËLLAZËRISË PRIZREN – SHKODËR, VAZHDON TRADITËN E TIJ TË MREKULLUESHME!



Ditën e shtunë, më 28 shkurt 2028, me ftesë të Kryetarit të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit, H. Valon Ibrahim, teologu Arben Halluni, drejtor i arsimit pranë Myftinisë Shkodër dhe anëtarë të Këshillit të Myftinisë Shkodër morën pjesë në iftarin e përvitshëm tradicional, të Këshillit të Bashkësisë Islame të Prizrenit.



Në postimin e tyre në facebook, Këshilli i Bashkësisë Islame Prizren, ndër të tjera shprehet:

"Këshilli i Bashkësisë Islame i Prizrenit, shtroi iftarin tradicional me strukturën e saj, si administratën, imamët, mualimët, dhe të gjithë bashkëpunëtorët lokal e qendror.

Në emër të nikoqirit, të pranishmit i përshëndeti kryetari i Këshillit, Valon ef. Ibrahim. Në emër të Komunës së Prizrenit, i përshëndeti kryetari i Komunës, z. Shaqir Totaj. Në emër të mysafirëve nga Shqipëria, z. Arben Halluni nga Shkodra!"

Kjo traditë e mrekullueshme e sofrës së begatë të iftarit tashmë është konsoliduar dhe përsëritet çdo vit me ardhjen e muajit të Begatë të Ramazanit.

MYFTIU I SHKODRËS: “FITËR BAJRAMI, MUNDËSI DREJT PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË JETËS!”

Ditën e xhuma, më 20 mars 2026, në ditën e parë të Fitër Bajramit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, dha një intervistë për Radio “Projekti 21” në Kopenhagën të Danimarkës, ku nëpërmjet mesazhit të tij u drejtua radiodëgjuesve dhe përtej tyre, me një mesazh, nëpërmjet të cilit uroi të gjithë besimtarët me rastin e kësaj feste të madhe për mbarë botën islame, sikurse vuri theksin tek rëndësia që ka shfrytëzimi i ditëve të shënuara fetare, si mundësi drejt përmirësimit të cilësisë së jetës.

Në bashkëbisedimin e tij me gazetarin Luigj Shkodrani, Myftiu i Shkodrës, ndër të tjera tha: “Shumë i dashtur z. Luigj, më lejoni që në radhë të parë t’ju përhapoj ju dhe krejt dëgjuesit e Radios “Projekti 21”, në Danimarkë me rastin e Fitër Bajramit me shpresën dhe lutjet më të mira, që të jetë një shenjë e bekimeve të Zotit të gjithësisë për të gjithë ne pa përjashtim. Patjetër që ditët festive në jetën e njeriut krijojnë një hapësirë dhe një atmosferë shumë të begatë. Është një ndryshim për të cilin njeriu ka nevojë dhe Zoti i gjithësisë e di këtë më së miri, prandaj na i sjell këto festa si shenjë e dashnisë së Tij për ne dhe njëkohësisht, si dëshmi e një përkushtimi të madh, me të cilin i jemi përgjigjur thirrjes së Tij në një moment prej momenteve të caktuara të jetës.

E kështu, pas obligimit të agjërimit të muajit të Ramazanit, 30 ditë apo 29 ditë sipas kalendarit hënor, vjen festa e Fitër Bajramit, si një mirësi shumë e madhe nëpërmjet së cilës Zoti Fuqiptotë don të na tërheqë drejt dashnisë së Tij, dhe njëkohësisht kërkon që dritën dhe mirësinë e kësaj dashnie ta përhapim edhe në mesin tonë, duke uruar njëri-tjetrit, duke u përqaftuar me njëri-tjetrit, duke u pajtuar dhe paqtuar me njëri-tjetrit, e duke shpërndarë shpresë dhe dritën e besimit me çdo njeri, besimtar qoftë a jo, prej pjestarëve të shoqërisë, me të cilët ne jetojmë e bashkëjetojmë çdo ditë.

Për ne si shqiptarë, festat fetare janë edhe një moment fatlum për t’u parë edhe më shumë me njëri-tjetrit, për t’u takuar, për t’u afruar, për të

rritur nivelin e bashkëpunimit dhe të paqes sociale me njëri-tjetrit, qoftë muslimanët brenda bashkësisë së tyre, kudo qofshin e sado qofshin, e qoftë muslimanë e të krishterë, e çfarëdo qofshin pjestarët e tjerë të shoqërisë tonë, që urojnë njëri-tjetrit me rastin e festave fetare, në këtë rast, Fitër Bajramin, dhe duke marrë e duke ndarë me njëri-tjetrit gëzimin personal.

Edhe ne si muslimanë, në këtë ditë të bekuar dhe në këtë atmosferë të mrekullueshme të Fitër Bajramit, patjetër që ndajmë gëzimin e besimit tonë dhe gëzimin e zemrës sonë, me krejt pjestarët e shoqërisë sonë, duke ndarë si të thuash këtë tortë të madhe të mirësisë hyjnore me të gjithë pa

EDHE NE SI MUSLIMANË, NË KËTË DITË TË BEKUAR, EDHE NË KËTË ATMOSFERË TË MREKULLUESHME TË FITËR BAJRAMIT, PATJETËR QË NDAJMË GËZIMIN E BESIMIT TONË, E GËZIMIN E ZEMRËS SONË, ME KREJT PJESTARËT E SHOQËRISË SONË, DUKE NDARE SI TË THUASH KËTË TORTË TË MADHE MIRËSINË E HYJNORE ME TË GJITHË PA PËRJASHTIM.

përjashtim. Pra, është një nxitje për t’u bërë më nikoqirë, për t’u bërë më bujarë, për t’u bërë më zemërgjerë, mos me e mbajt të mirën vetëm për vete, por me ndarë edhe me të tjerët.

Dhe, sa bukur është kur në një shoqëri, ku ka diversitet, në një shoqëri ku ka, si të thuash ngjyra plot, me u përhap e mira pa koprraci, e me u përhap e mira që kemi për vete edhe me tjetrit, si për t’i thënë ti nuk je i huaj në sytë e mi, e ti je pjesë e kësaj familjeje, je pjesë e kësaj shtëpie të madhe, e bashkërisht si njerëz të Zotit e krijesa të Tij, jemi të ftuar që të mirën e Zotit ta ndajmë me njëri-tjetrit.”

Myftiu gjithashtu u drejtua edhe besimtarëve muslimanë, por jo vetëm, në mërgatë, ku vuri theksin tek rëndësia e ruajtjes dhe dëshimit të identitetit fetar si pjesë e natyrshmërisë së njeriut, si dhe si një mundësi më shumë për

t’u përhapur humanizmi, mëshira dhe morali i besimit gjithandej nëpër botë.

Myftiu e mbyllin mesazhin e tij me urimin: “Më lejoni që njëkohësisht t’i drejtohem me një përshëndetje shumë të veçantë dhe një urim të përzemërt të gjithë pjestarëve të Bashkësisë Muslimane Shqiptare në Kopenhagën në Danimarkë, por në krejt vendet skandinave, një urim me të cilën uroj vëllezërit e mi, muslimanë e shqiptarë, atje e kudo qofshin, me shpresën dhe me lutjet që Allahu Fuqiptotë t’ia pranojë agjërimin e Ramazanit dhe veprat e mira gjatë këtij Muajit, me të cilin sapo u ndamë; leximin e Kur’anit, kuptimin e tij, dëshmimin e vlerave të tij në jetën tonë të përditshme, përpjekjen për të përhapur dritën e Fjalës së Zotit me të gjithë, në çdo pozicion ku Zoti na ka ftuar dhe na ka vendosur në jetën kalimtare të kësaj bote të përkohshme.

Njëkohësisht, lutem me zemër që drita edhe mirësitë, me të cilat u mësua në Muajin e Begatë të Ramazanit, të vazhdojnë në mesin tonë, të përhapen në mesin tonë, e të jenë pjesë e natyrës sonë të përditshme. Pra, si të thuash, t’i fitojmë shprehitë e muajit Ramazan, për ta bërë jetën më të bukur.

Dhe, ashtu sikurse u them edhe vëllezërve të mi në Shkodër dhe në çdo vizitë e udhëtim timin, kudo në perëndim, por jo vetëm, është shumë e rëndësishme që mësimet e fesë, edhe vlerat e besimit t’i dëshmojmë në mënyrë të natyrshme pa sforcim, dhe duke e shijuar fillimisht personalisht atë mirësi që marrim, e duke e ndarë me të tjerët, për të shijuar pastaj bekimet e Zotit në krejt shoqërinë tonë.

Ju falënderoj shumë për mundësinë që më dhatë për të komunikuar me ju dhe me vëllezërit e mi që na dëgjojnë, dhe shpresoj e lutem që të kemi përherë mbarësi dhe bekime në jetën tonë, e shqiptarët në veçanti të ecin përpara, të kenë bekime dhe mirësi nga Zoti i gjithësisë, për të jetuar në paqe me njëri-tjetrit dhe me këdo, me të cilin ata jetojnë e bashkëpunojnë kudo qofshin.

Paçi bekimet e Zotit të gjithë pa përjashtim, e me zemër të mirë Fitër Bajramin!”

PRITJA TRADICIONALE E VIZITAVE PËR FITËR BAJRAM



Në atmosferën e ngrohtë dhe festive të Fitër Bajramit, sot më 20 mars 2026, në ambientet e xhamisë së Parrucës në Shkodër u zhvillua pritja tradicionale e vizitave, ku besimtarë dhe përfaqësues të institucioneve vendore dhe fetare erdhën për të ndarë urimet dhe gëzimin e kësaj Dite të Begatë.

Teologu Arben Halluni së bashku me imamë dhe pjesëtarë të stafit të Myftinisë Shkodër pritën drejtues vendorë nga Prefektura, Këshilli i Qarkut, Bashkia, përfaqësues të subjekteve politike, etj, të cilët përcollën urimet e tyre më të ngrohta për këtë Festë të madhe islame, duke vlerësuar rolin e komunitetit në forcimin e harmonisë dhe bashkëjetesës.

Me rastin e kësaj vizite, Mons. Giovanni Peragine, Arqipeshkvi i Shkodër-Pultit, uroi besimtarët muslimanë, duke dhënë një mesazh të respektit ndërfetar, harmonisë dhe bashkëpunimit mes komuniteteve fetare në qytetin e Shkodrës.



DHURATA E FITËR BAJRAMIT PËR 100 NXËNËS TË XHAMISË NË BARBULLUSH

Dy Bajramet janë ditë gëzimi dhe hareje, sidomos për fëmijët, që bëhen gati të presin dhurata e të papritura të këndshme, që i japin kuptime reale këtyre ditëve të begata festive, pikërisht siç thotë e Pejgamberi (a.s): “Ditët e Bajramit janë ditë të ngrënies dhe të pijes dhe ditë të përmendjes së Allahut të Madhëruar!”

Kështu erdhi ky Fitër Bajram edhe për 100 nxënës frekuentues të xhamisë së fshatit Barbullush, ku pas faljes së namazit të Bajramit të kësaj dite të shënuar, atyre iu kushtua vëmendja më e madhe!

Nën drejtimin e imamit të xhamisë, të nderuarit, H. Ervis Molla, u zhvillua një program i gëzueshëm për fëmijët e xhamisë, të cilëve iu shpërnda edhe

dhurata simbolike e kësaj dite, duke i dhënë kuptimet më të larta të gëzimit dhe shpërndarjes së haresë e mirësisë në mesin e besimtarëve.

Pjesë e programi ishte edhe prania e lodërtarit të Bajramit, i cili u rrethua nga nxënësit, duke krijuar një mozaik të paharruar, simbol i kësaj dite.





MYFTINJA
SHKODËR

Mubarek Fitër Bajramin!

E XHUMA | 20 MARS 2026

Myftinia Shkodër ju uron:

Gëzuar Festën e Begatë të Fitër Bajramit!

*Allahu i Madhëruar jua pastë pranuar agjërimin
dhe të gjitha adhurimet tuaja!*



[f](#) [X](#) [@](#) /@myftinia-shkoder.org

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

[f](#) [You Tube](#)
MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org